



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni Parlamentar për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.06.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 28.06.2019.
2. Miratimi i draftkalendarit trejavor të punës së komisionit për periudhën 3 – 21 qershor 2019.
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore””.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Ditmir Bushati, Eglantina Gjermeni, Evis Kushi, Ralf Gjoni, Vasil Sterjovski, Bashkim Fino, Andrea Marto, Adnor Shameti, Elona Hoxha, Eljo Hyskaj, Ervin Bushati, Alket Hyseni dhe Vasilika Hysi.

Mungojnë:

Rudina Hajdari, Reme Lala dhe Ligoraq Karamelo.

Të ftuar:

Pandeli Majko – Ministër Shteti për Diasporën

Fran Brahimi – Drejtor i Financave Vendore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëdita të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Politikën e Jashtme, datë 10.06.2019, me këtë rend dite: miratimi i procesverbalit të datës 28.06.2019, miratimi i draftkalendarit trejavor të punës së komisionit për periudhën 3 – 21 qershor 2019, si dhe shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore””.

Relator kemi kolegun Shameti, por, ndërkohë, falënderojmë ministrin e Shtetit për Diasporën, zotin Pandeli Majko, dhe zotin Fran Brahimi, drejtor i Financave Vendore në Ministrinë për Ekonominë dhe Financave! Mirë se vini, të nderuar zotërinj! Kam kërkuar të jetë prezent edhe kolegu Fino, meqenëse ka qenë relator i ndryshimeve në këtë ligj për një kohë të gjatë edhe në Komisionin e Ligjeve.

Ndaj, një mirëseardhje të veçantë ia uroj kolegut Fino, i cili është prezent!

Ministri Majko, ju lutem, na thoni shkurtimisht dy fjalë lidhur me ndryshimet që keni sjellë para komisionit tonë.

Pandeli Majko – Projektligji vjen në vazhdim të diskutimit në parim që kemi bërë herën e kaluar, zonja kryetare, ku ndryshimi i këtij projektligji parashikon hapjen e një zyre të veçantë për diasporën dhe emigracionin, si dhe për shërbimet që do t’i ofrohen kësaj kategorie dhe shtrese të shoqërisë shqiptare në çdo bashki.

Nisur edhe nga numri i lartë i emigracionit, i cili tashmë nuk është sasi, por është cilësi e shoqërisë sonë, besoj se hapja e një zyre të tillë do t’i jepte goxha akses një komuniteti, i cili i ndjek zhvillimet, sidomos nëpër bashki, nga distanca. Për më tepër, ashtu siç është diskutuar edhe më parë apo siç është paraqitur edhe në relacionin shpjegues, ky diskutim është kryer edhe në bashkëpunim me pushtetin lokal, ku kemi pasur përkrahjen e të gjitha forcave politike në këshillin që ekziston ndërmjet ekzekutivit dhe pushtetit lokal gjatë muajve maj-qershor të vitit të kaluar, duke e mbyllur si proces në muajin shtator.

Mendoj se projektligji i ka realizuar të gjitha konsultimet, duke pasur parasysh edhe pyetjet, shqetësimet dhe problematikat e ngritura në mbledhjen e Komisionit të Jashtëm dhe atij të Ligjeve, të cilat i kemi diskutuar, në veçanti edhe me relatorët, me zotin Shameti dhe zotin Fino, dhe me përfaqësuesin e Ministrisë së Financave e më gjerë, duke i rregulluar të gjitha problematikat e ngritura si shqetësime në mbledhjet respektive të të dyja komisioneve parlamentare që përmenda më lart.

Jemi të hapur për çdo pyetje dhe sugjerim nga ana juaj.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Ministër!

Fjalën e ka kolegu Shameti, në cilësinë e relatorit.

Adnor Shameti – Faleminderit, zonja kryetare!

Në vijim të asaj që diskutuam edhe gjatë miratimit në parim të projektligjit, duke qenë se kemi prezent edhe zotin Fino, në cilësinë e relatorit të komisioni përgjegjës, që është ai i Ligjeve, por edhe duke qenë se pak a shumë i kemi shqyrtuar dhe ezauruar të gjitha çështjet dhe pyetjet që shtruan për diskutim edhe në seancën e miratimit në parim, pa dashur t’ju marr më shumë kohë nga sa duhet, dua të referoj vetëm rekomandimet përfundimtare dhe ato t’i shikojmë përfundimisht në Komisionin e Ligjeve, që është komisioni përgjegjës. Besoj se do të kem të gjithë mirëkuptimin e zotit Fino për sa më sipër.

Ajo që dua të them është që, përfundimisht, në Komisionin e Jashtëm sugjerojmë që neni 2 të hiqet, sepse ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” parashikon konsultimin e nismave, politikave dhe të legjislacionit që ka ndikim në funksionet e qeverisjes vendore me shoqatat përfaqësuese të vetë njësive, duke marrë në konsideratë pikërisht të drejtën e njësive të vetëqeverisjes vendore për t’u organizuar në shoqata.

Në këtë kuadër, tashmë janë konsoliduar dy shoqatat kryesore, të cilat përfaqësojnë interesat e njësive të vetëqeverisjes vendore në tërësinë e funksioneve që kryhen prej tyre, referuar neneve 22-29 të po këtij ligji.

Neni 3, ku thuhet: “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare”, duhet të dalë si nen më vete, pasi dispozita që përcakton hyrjen në fuqi të aktit duhet të evidentohet në një nen të pavarur.

Gjithashtu, nga ana e teknikës legjislative, sugjeroj rregullimin e bazës ligjore në preambulë, duke e saktësuar atë si më poshtë: “Në mbështetje të neneve 13, 78, 81 (pika 2), 83 (pika 1) e 108 deri në 115 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, si dhe në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” bëhen këto shtesa dhe ndryshime”.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Shameti!

Fjalën e ka zoti Fino.

Bashkim Fino – Faleminderit, zonja kryetare!

(Deputeti Fino flet pa mikrofon.)

Faleminderit, zoti Ministër, që jeni prezent këtu!

Ky është një projektligj i ardhur nga ministri i Shtetit për Diasporën, nëpërmjet të cilit duam të fusim në funksionet e bashkive një funksion të ri, atë që ka të bëjë me fushën e diasporës dhe emigracionit.

Nga pikëpamja e teknikës legislative, Kushtetutës dhe ligjit që ne kemi bërë, nuk ka asnjë pengesë për të mos e bërë një shtesë të tillë, sepse është një funksion që me ligj mund t'ua shtojmë organeve të pushtetit vendor.

E vetmja gjë, që unë e vë pak në pikëpyetje, do të ishte: mund ta vendosim në ligj, sepse e kemi të drejtën që t'u themi kryetarëve të bashkive dhe këshillave përkatës për krijimin e një strukture të posaçme, por ndoshta në funksionet e pushtetit vendor duhet të lëmë që të shtohet edhe një detyrë tjetër në fushën e diasporës dhe të emigracionit. Natyrisht, në momentin kur ia shtojmë si detyrë dhe funksion, absolutisht ata e kanë për detyrë të ngrenë strukturat e reja. Ato mund të ngrenë struktura të reja me këtë emërtim ose struktura në vazhdim të strukturave që kanë vetë ata, për shembull, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë ose drejtori të ndryshme, që mund të jenë nëpër bashkitë përkatëse, të shtojnë një sektor që mund të merret me diasporën dhe emigracionin. Kjo është një gjë tejet pozitive. Por aktet nënligjore, që do të nxjerrë ministri i Shtetit për Diasporën ose edhe ministri i Financave, do ta bëjnë detyruese që kryetarët e bashkive ta trajtojnë këtë problem.

Gjithsesi, edhe në qoftë se germa “a” mbetet siç është: “Krijimi i strukturës së posaçme për diasporën dhe emigracionin”... Pse them që të mos e themi pjesën e parë “krijimi i strukturës”? Sepse mund të ngrihen shoqatat që na kanë dhënë okejin për projektligjin dhe na thonë: “Ma shtove një funksion, si pushtet vendor? Të lutem, ma shoqëro pak me faturë financiare! Të lutem, më trego ti, si shtet, sa veta do të më shtosh në 61 bashkitë për të trajtuar një funksion si diaspora dhe emigracioni, sa do të jetë fondi i pagave për këta njerëz?”, gjë të cilën ne, përgjithësisht, nuk e kemi shtuar me faturë financiare, por e kemi lënë të nënkuptohet që, kur ata marrin buxhetin e shtetit dhe nga grantet e pakushtëzuara që ne u japim, ata të kenë hapësirën dhe mundësinë e rikonceptimit të strukturës, pasi këtë të fundit e miraton kryetari i bashkisë nëpërmjet këshillit bashkiak dhe mund të shtojë një ose dy emra. Natyrisht, kjo do të bëhet sipas madhësisë së bashkisë. Kuptohet, një bashki e madhe do të ketë më shumë njerëz, ndërsa një bashki mund të ketë edhe vetëm një njeri që mund ta trajtojë këtë çështje. Prandaj them që formulimin “krijimi i strukturës së posaçme” mund ta lëmë kështu, por nesër, ta dini edhe ju, edhe ata kur të vijnë për buxhetin, që të mos na kërkojnë faturën financiare.

Në momentin që ne e lëmë të hapur dhe themi: “Në funksionet e bashkive do të shtohet një funksion i ri, ai për diasporën dhe emigracionin”, ata e kanë detyrim ligjor në momentin kur e miratojmë ligjin që t’i dalin për zot kësaj fushe.

Pikat e tjera, siç e tha edhe zoti Shameti, nuk kanë probleme.

Lidhur me nenin 2, kemi rënë dakord me ministrin Majko që nuk duhet të jetë, sepse është i tepërt.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Grupin e diasporës dhe përfaqësuesit e tyre nuk mund t’i quajmë grup interesi, sepse grupe interesi janë tri shoqatat që ekzistojnë sot në Shqipëri: shoqata e pushtetit vendor, shoqata e bashkive dhe shoqata e qarqeve, që janë grupe interesi tamam kur diskutohen ligje të posaçme për pushtetin vendor.

Kështu që kemi rënë dakord që neni 2 të rrëzohet, ndërsa për nenin 3 kemi bërë një diskutim, por ky është një nen që nuk është paraqitur nga ministri i Shtetit për Diasporën, sepse nuk ka të bëjë me anën financiare pikërisht për të, por, meqenëse ne po e hapim këtë ligj, të mos harrojmë që ky ligj është organik i cilësuar me tre të pestat e votave dhe kërkon 84 vota, do të thotë se këtu bëhet fjalë për diskutimin e buxhetit faktik, që bëjnë këshillat bashkiakë në fillim të vitit të ri.

Afati 31 mars, që kemi në ligjin e pushtetit vendor, ka çeduar gjithnjë dhe nuk është realizuar i tillë, për shkak se sa janë kontrolluar bilancet edhe nga kompanitë e huaja e të tjerë. Prandaj në ligjin “Për financat vendore”, që ne e kemi kaluar si parlament, kemi caktuar afatin 31 majin si afatin maksimal të diskutimit të buxhetit faktik. Kjo do të thotë që neni 3 bën një rregullim ndërmjet ligjit të pushtetit vendor me atë të financave vendore, si dhe të asaj që ka ndodhur sot në praktikë, që ne ta njësojmë me një datë të caktuar, pra me 31 majin dhe jo me 31 marsin, që ka ligji i pushtetit vendor, duke bërë një rregullim, po themi, të një teknikaliteti legjislativ.

Natyrisht, ne si Komision i Ligjeve, që kemi edhe Nënkomisionin e Pushtetit Vendor, i kemi parë në tërësi funksionet dhe, meqenëse i prekëm, bëj me dije edhe Komisionin e Jashtëm, se ne do të ndërhyjmë në projektligj, në një nen të caktuar të funksioneve, tek ai që bën fjalë për tjetërsimin e pronave.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në ligj e kemi të shkruar shprehimisht dhe qartësisht se, kur kemi të bëjmë me tjetërsimin e pronave, këshilli bashkiak do të votojë me tre të pestat e numrit të anëtarëve të tij, pra kur ka të bëjë me një shitje prone, dhe nuk diskutohet që do ta lëmë kështu, por kur ka

të bëjë me, si të thuash, zhvillim ekonomik ose dhënie me qira të një prone nga bashkia, nuk ka pse ta lidhim këmbë e duar kryetarin e bashkisë ose këshillin përkatës për të votuar me tre të pestat, por mund të votohet me gjysmën e këshillit bashkiak, pra me 50%+1 të vendeve që ka këshilli përkatës, kur jepet një pronë për zhvillim ose me qira, por jo për tjetërsimin e saj. Tjetërsimi do të mbetet me tre të pestat.

Do të bëjmë edhe një ndryshim të vogël te funksionet, pa dashur të hapemi shumë në ligjin e pushtetit vendor.

Së fundi, duke e vlerësuar zotin Majko, që na e solli këtë projektligj për shkak të diasporës dhe emigracionit, duke bërë edhe këto dy ndryshimet teknike më tepër të fushës financiare sesa të fushës së diasporës, mendoj se është plotësisht i mundshëm që ky projektligj të kalojë dhe, natyrisht, kërkon një votim me shumicë të cilësuar, me tre të pestat, pra me 84 vota, sepse ne gjithmonë e kemi bërë këtë ligj bashkërisht me opozitën. Por jam i bindur, sepse kam folur edhe me opozitën e re në parlament, dhe është një çështje e teknikës, e cila nuk ka të bëjë me ndonjë gjë politike, por me një funksion të ri që ne u japim organeve të pushtetit vendor, për shkak të diasporës që e kemi në një numër të konsiderueshëm dhe duam që të jetë sa më afër vendimmarrjes për ne.

Kjo ishte pak a shumë një rezymë e të gjithë projektligjit dhe për çfarë kemi rakorduar me ministrin Majko, edhe me këshilltarët tuaj. Besoj se me mirëkuptimin tuaj këto tri nene do të kalohen duke miratuar nenin 1, duke mos miratuar nenin 2 dhe duke miratuar nenin 3. Pjesa tjetër i takon Komisionit të Ligjeve për ta definuar përfundimisht, meqenëse jemi komision përgjegjës, dhe ta përcjellim në seancë plenare për votim.

Shumë faleminderit për vëmendjen!

Mimi Kodheli – Faleminderit, kolegu Fino, për sqarimet dhe prezencën, që besoj se janë të vlefshme për të arritur në konkluzionet që duhen dhe në mendimin që ky komision do të japë, pavarësisht se komisioni ynë është për dhënie mendimi.

Vijojmë tani me pyetje nga kolegët.

Kush e do fjalën? Po, zoti Gjoni.

Ralf Gjoni – Faleminderit, zonja kryetare!

Dua të përshëndes punën e deritanishme të ministrit të Shtetit për Diasporën, të zotit Majko, sepse ka sjellë vërtet në vëmendjen e institucioneve, por edhe të opinionit publik, rëndësinë që kanë diaspora dhe shtetasit shqiptarë me banim jashtë Shqipërisë për zhvillimin ekonomik, social dhe politik të vendit!

Unë kam një koment për nenin 2. Personalisht, nuk e shoh të rëndësishëm ose të nevojshëm shtimin e fjalëve “përfaqësuesve të diasporës”. Pra, dua thjesht të shpreh mbështetjen për grupet e interesit; mjafton!

Kam edhe një pyetje, zoti Majko. Diaspora përbëhet edhe nga shtetas shqiptarë me banim jashtë Shqipërisë, edhe nga bashkëkombës të vendeve shqipfolëse ose të rajoneve shqipfolëse rreth e rrotull, që banojnë jashtë shtetit.

Për sa u përket shtetasve shqiptarë të Republikës së Shqipërisë me banim jashtë shtetit, referuar germës “d”, a mund të specifikohet edhe përgjegjësia që kanë autoritetet vendore, bashkitë, për sa i përket konsolidimit të listave zgjedhore? Sepse, në fund të fundit, kemi të bëjmë me një detyrim që e ka ekzekutivi, qoftë ai qendror, qoftë ai lokal, në kuadrin e reformës zgjedhore. Pastaj, konsolidimi i listave zgjedhore është edhe rekomandim i OSBE-ODIHR-it.

Në fund të fundit, bashkitë duhej të kishin filluar me kohë nga puna për qartësimin e listave të gjendjes civile. Ata shtetas shqiptarë, që banojnë jashtë shtetit dhe janë të regjistruar diku jashtë Shqipërisë, nuk kanë pse të jenë pjesë e listave zgjedhore të Republikës së Shqipërisë. A e keni menduar këtë? A mund të shtohet kjo?

Mimi Kodheli – Zoti Majko, fjala është për ju.

Pandeli Majko – Faleminderit!

Në fakt, ne po diskutojmë një ndryshim, i cili, në thelb, prek nenin 29/1 për funksionet e bashkive në fushën e diasporës dhe të emigracionit.

Mendoj se shqetësimi që ngriti zoti Gjoni është realist, por nuk ka të bëjë me ndryshimin e këtij neni. Për më tepër, që të hapim këtë lloj diskutimi tani për interesat e pushtetit lokal në marrëdhënie me shtetasit, që nuk janë rezidentë në Republikën e Shqipërisë, do të kërkonte një diskutim pak më specifik, më të shtruar dhe, sidomos, të lidhur me Kodin Zgjedhor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pa diskutim, edhe në kuadrin e diskutimit të gjithëpranuar sot në publik, edhe në politikë, për sa i përket të drejtës së votës së shtetasve që jetojnë jashtë vendit, ajo do të marrë një dimension tepër të veçantë, pasi, normalisht, ne do të kemi dy lloj votuesish: votuesit që janë me banim në Shqipëri dhe ata që nuk janë me banim në Shqipëri. Por, normalisht, kjo do të jetë një histori e reformës e zgjedhore, e cila po diskutohet në vazhdim nga komisioni parlamentar respektiv.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Ka pyetje të tjera? Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Duke marrë shkas nga pyetja e zotit Gjoni dhe përgjigjja e ministrit Majko, këto janë funksione, të cilat ua delegojmë bashkive përkatëse.

Nuk bëhet fjalë këtu për çështjet e listave, sepse ajo është çështje e reformës ose e Kodit Zgjedhor. Unë dhe zoti Gjoni jemi anëtarë të Komisionit për Reformën Zgjedhore dhe, natyrisht, mund t'i ngremë si çështje atje. Madje shqyr që po u japim mundësinë bashkive të komunikojnë dhe të kenë forcim të mëtijshëm të marrëdhënieve.

Për shembull, unë mbuloj Bashkinë e Lushnjës dhe dua të di sa lushnjarë jetojnë në Kanada, në Amerikë, në Gjermani, të cilët kërkojnë, si të thuash, një komunikim me organet e pushtetit vendor në çdo fushë, qoftë edhe në fushën e investimeve e të tjera, për të dhënë ndihmesa të jashtëzakonshme për bashkinë e tyre. Ata jetojnë mirë e bukur atje ku janë, por, nëse nesër ne do ta vendosim në Kodin Zgjedhor që diaspora dhe shqiptarët që jetojnë jashtë atdheut do të votojnë, kjo është çështje që e vendos Kodi Zgjedhor. Në momentin që e vendos ky i fundit, do të marrin detyra qoftë ministri i Shtetit pranë Kryeministrit ose Ministria e Jashtme, pse jo, pastaj edhe bashkitë për të bërë listimin e tyre.

Listimin e tyre nuk mund ta bëjë dot bashkia. Ajo mund të japë të dhëna nga Gjendja Civile se i ka tashmë: sa banorë dhe sa votues ka, për shembull, Bashkia e Lushnjës, por ajo do të jetë, si të thuash, e kolauduar më saktë me ministrin e Shtetit për Diasporën, me përfaqësitë tona diplomatike jashtë se çfarë do të votojnë dhe si do të votojnë.

Ndërkohë, këtu kemi të bëjmë me funksione, nëpërmjet të cilave duam të kemi një komunikim: të forcojmë marrëdhëniet e diasporës me bashkitë përkatëse; t'u japim informacionin e nevojshëm atyre për mënyrën si e fitojnë shtetësinë, çfarë të dhënash duan që ne të jemi të gatshëm... Pra, të kenë një zyrë që, kur vijnë në Lushnjë, qoftë edhe për të takuar të afërmit e tyre, të konsultohen dhe të marrin *feedback*-un e nevojshëm për çdo gjë që ata duan të pyesin: në fushën ekonomike, në fushën e fitimit të shtetësisë, në fushën e ndihmës së informacionit për legjislacionin shqiptar (si ka ecur dhe sa është i përafëruar me atë të Bashkimit Europian), qoftë edhe për koordinimin dhe bashkëpunimin e punëve. Pastaj do të ketë një akt nënligjor se si do të punojë kjo zyrë për këta emigrantë ose për këtë diasporë që ne kemi, realisht, dhe besoj se këto funksione janë të mjaftueshme. Madje, mund të ketë edhe elemente të tjera, mund t'i jepen detyra të tjera kësaj zyre, por ne japim gjërat kryesore në ligj, duke u thënë bashkive: e keni edhe këtë funksion. Mund të mos e trajtonin fare, siç nuk e kanë trajtuar, por me këtë gjë i lëmë detyrë që minimalisht do të ketë një zyrë, një sektor pranë një drejtorie të caktuar që do të merret me këtë çështje.

Prandaj, e përsëris, çështja në fjalë ka të bëjë me zgjedhjet dhe reformën zgjedhore, jo me shtesat që ne i bëjmë ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera nga kolegët?

Po, urdhëroni!

Vasil Sterjovski – Faleminderit, zonja kryetare!

Dua të bëj një sugjerim në lidhje me pikën 2 për nxitjen e organizimeve brenda dhe jashtë vendit. Do të ishte mirë që bashkitë të ishin të detyruara, të paktën, të planifikonin një fond për organizimin e aktiviteteve kulturore ose festive.

Lidhur me pikën 1 për krijimin e strukturës së posaçme, nuk ka asnjë kosto financiare, sepse bashkitë i kanë mundësitë që t’ia delegojnë këtë të drejtë ndonjëres prej zyrave ekzistuese që kanë, kanë edhe staf të mjaftueshëm. Por mirë do të ishte që të dihej se për çdo bashki, që ka diasporën e saj kudo nëpër botë, të caktohej një ditë ose disa ditë si, për shembull, Dita e Diasporës së asaj bashkie. Kjo do të bënte që të ktheheshin më shpesh emigrantët dhe diaspora që kemi kudo nëpër botë. Për shembull, ta dinin që më 1 qershor do të kthehen se ka një aktivitet bashkia, kushtuar atyre. Nuk është ndonjë kosto e madhe për çdo bashki, normalisht të bëhet sipas bashkisë dhe buxhetit që kjo e fundit ka, por tani këto mundësi i kanë edhe bashkitë e vogla, jo më të mëdhatë, plus me bizneset që mund të krijohen... Por do të ishte mirë ta kishin detyrim ligjor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani, e ka këtë të drejtë edhe bashkia, siç është në ligj këshilli bashkiak, por po të ishte e detyrueshme me ligj, besoj se do të ishte më praktike.

Mimi Kodheli – Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Ne kaq kemi të drejtë të vendosim në ligj, pra japim, si të thuash, orientimet kryesore të ligjit. Pra, në funksionet që ka si kryetar bashkie, i themi: ke edhe këtë gjë.

Jam absolutisht dakord me të gjitha këto të tjerat që thatë ju, por këto kanë të bëjnë me organizimin e zyrës përkatëse, me vendimmarrjen që do të marrin në këshillin përkatës bashkiak, kur të kalojë buxheti i çdo bashkie.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Natyrisht, në buxhet, në qoftë se atyre u themi, si në germën “a”, do të krijojmë një strukturë të posaçme për këtë gjë, mbi bazën e strukturës që do të krijojë, që ia thotë ligji se do ta krijojë, automatikisht, kur të bëjë ndarjen e buxhetit ai do ta detajojë buxhetin mbi

bazën e grupeve, strukturës së posaçme që ka vetë bashkia. Natyrisht, edhe për këtë sektor, do të mundohet të planifikojë diçka. E gjithë problematika tjetër që thatë ju, janë problematika që do t'i ndjekë problematikën e përditshme zyra përkatëse për të bërë aktivitete etj. Kështu, në planin kryesor të ligjit ne jemi në rregull, se po krijojmë strukturën për diasporën.

Pse e krijojmë? Për nxitjen, për dhënien e mendimit të kësaj dhe në saj të kësaj, do të thotë që kjo zyrë që do të krijohet, natyrisht do edhe fondet përkatëse. Bashkia do t'ia japë dhe do t'ia vërë në dispozicion, se ata nuk janë kot atje, se do të bëjnë rreth 5 aktivitete gjatë vitit, siç i bëjnë nëpër bashki, edhe Zyra e Kulturës apo zyrat e tjera. Kështu, mos ki asnjë problem, sepse pika “a” e ezauron në momentin që e ngremë si strukturë dhe më pas, nuk ka problem për zgjidhjen e problematikës.

Natyrisht, na takon ne si Nënkomision i Pushtetit Vendor dhe i Legjislacionit për të bërë kontrollin e nevojshëm. Ne vërtet bëjmë ligje, por duhet të dimë se kemi edhe forcën për të bërë kontrolle në çdo bashki për të parë se si punojnë ata për të zbatuar një ligj të caktuar, aq më shumë ligjin nr. 139, që është ligji kryesor i vetëqeverisjes vendore.

Mimi Kodheli – Faleminderit, kolegu Fino!

Unë kisha një pyetje për përfaqësuesin e Ministrisë së Financave.

Kemi kërkuar nga Ministria e Shtetit për Diasporën një ditë më parë një kopje të korrespondencës që ju keni pasur me ministrin e Shtetit për Diasporën për aprovimin që ju keni dhënë për raportimin të mbylljes së buxhetit jo në 31 mars, por shtyrjen e këtij afati deri më 31 maj.

Na është thënë se ky komunikim ekziston, por unë nuk kam parë të ketë një faksimile të kësaj korrespondence. A ekziston kjo korrespondencë me Ministrinë e Shtetit për Diasporën? Nëse është, kërkoj nga ju, si përfaqësues i Ministrisë së Financave të na e bëni prezent.

Fran Brahimi – Po, është kjo korrespondencë.

Theksoj se nevojat (zoti Fino e shpjegoi mjaft mirë, që ne kemi një standard për buxhetin qendror) dhe në momentin që Ministria e Shtetit për Diasporën ka prurë këtë propozim, ne u fokusuam te ky propozim për të dhënë mendim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për ndryshimin ,që ka propozuar Ministria e Shtetit për Diasporën.

Për nenin tjetër, që ka të bëjë me harmonizimin e datave të raportimit financiar të pushtetit vendor te këshilli, ne kemi përfituar, meqë po preket ashtu siç e tha zoti Fino, do të

ndërhyhet në këtë ligj për ta harmonizuar afatin që ishte më 31 mars me datën 31 maj, sepse më 31 mars llogaria e shtetit apo thesari ynë nuk i nxjerr të dhënat përfundimtare për raportin përfundimtar të institucioneve publike, pra as për nivelin qendror, as për nivelin vendor. Kjo ka qenë arsyeja e parë.

Arsyeja e dytë ka qenë...

Mimi Kodheli – Fran,

Unë nuk dua të di arsyet, as se ku jeni fokusuar, por unë dua të di, si komision kemi kërkuar shpjegime dhe korrespondencën e përsëris edhe një herë, ku Ministria e Financave bie dakord me të gjitha ndryshimet që propozon Ministria e Shtetit për Diasporën, duke përfshirë edhe datën e raportimit të institucionit në bashki, në këshill.

Fran Brahimi – Dakord, tani e kuptova.

Mimi Kodheli – Dua të di edhe datën e raportimit që duhet të japë bashkia, sepse çdo gjë lidhet me thesarin. Janë disa gjëra, që ju i dini më mirë sesa unë. A e keni dhënë këtë opinion pozitiv në mënyrë që ne të mund ta pranojmë edhe *de facto* jo vetëm *de jure*, sipas shpjegimit që me të drejtë zoti Fino e dha?

Fran Brahimi – Po, e kemi dhënë zyrtarisht para se projektvendimi të shkonte...

Mimi Kodheli – Kërkojmë që kjo letër, kjo korrespondencë, të na vihet në dispozicion. Duhet vetëm të thoshit se e keni me të gjitha shpjegimet përkatëse pse mund t'ia lejoni vetes këtë “cedim financiar” dhe ne jemi në rregull.

Nëse ju, si Ministri Financash thoni se është në rregull, ne nuk ju kundërshtojmë, sepse jeni ju ata që e dini disiplinën financiare se si duhet të funksionojë, kur flasim për datat, por unë dua që të na e vini në dispozicion brenda ditës së sotme në mënyrë që raportin që unë dhe relatori do të firmosim pas kësaj mbledhjeje të mund të ketë bashkëngjitur edhe përgjigjen pozitive, që ka ardhur nga Ministria e Financave pikërisht për këtë gjë, jo për të gjitha ndryshimet e tjera sepse e kuptuam që keni rënë dakord për të tjerat.

Fran Brahimi – Dakord. Sapo të kthehem në ministri do t'jua nis dokumentin të skanuar me *e-mail* apo me postë, si ta doni.

Mimi Kodheli – Ju falënderoj!

Bashkim Fino – Përveç kësaj, nga pikëpamja e paraqitjes, duhet të vijë siç vjen për shembull Xhemal Qefalia me xhakëtë këtu, jo me këmishë me mëngë të shkurtra, se ky është Komisioni i Jashtëm dhe këtu ka të bëjë me ish-ministra të Jashtëm.

Desha të them edhe diçka: relacioni që ka sjellë KM-ja është një relacion shpjegues, i cili i ka kaluar filtrat e ministrive përkatëse dhe neni në fjalë që ju e kërkon me të drejtë, do

të thotë që ajo letër dhe ai sqarim që Ministria e Financave ka me Ministrinë e Shtetit për Diasporën për nenin 3 të projektligjit duhet ta sjellë zyrtarisht edhe te ne për të arsyetuar nenin 3 për ndërrimin e datave nga 31 marsi më 31 maj. Kjo është thjesht një gjë teknike. Frani e bën kaq gjë, se ai bën buxhetin dhe jo më të bëjë një letër dhe ta sjellë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Fran, kur t’jua jap unë fjalën, do ta merrni!

Fran Bardhi – Dakord.

Nuk është hera e parë që unë vij për ligjet. Ne nuk e kemi pasur praktikë të sjellim gjëra të tilla, sepse kur Këshilli i Ministrave sjell projektligjin, sjell të gjithë praktikën, por unë sapo të kthehem në ministri do t’jua nis dokumentin për praktikën që kemi me ministrin e Shtetit për Diasporën. Ne nuk ishim njoftuar për të sjellë një dokument të tillë.

Mimi Kodheli – Ne ia kishim kërkuar ministrisë respektive dhe nuk kemi pse jua kërkojmë juve, por ju mund të keni praktikën tuaj. Ne në parlament kemi praktikën tonë, zotëri. Ju jeni i detyruar të sillni çdo letër që ne kërkojmë, pavarësisht se me të drejtë zoti Fino thotë se qeveria ka thënë se Ministria e Financave e ka sjellë këtë, ne kemi të drejtë që mosbesimin ta ngremë në institucion. Po të ishte kështu, qeveria e sillte dhe ne e miratonim dhe nuk e diskutonim. Ne kemi detyrimin t’i shkojmë deri në fund çdo karte që këndon, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ke të drejtë vote, zoti Fino, sepse jeni deputet zëvendësues, po aq sa edhe zoti Qefalia, që jo vetëm do të siglojë, por edhe do të votojë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Fjalën e ka ish-ministri Bushati për një pyetje!

Ditmir Bushati – Faleminderit zonja kryetare!

Falënderoj edhe kolegët për prezantimin që i bënë projektligjit këtu!

Kam 2 pyetje. Pyetja e parë është në lidhje me efikasitetin e strukturave, që janë atashuar sot për sot pranë pushtetit vendor. Te pjesa materiale që flet për konsultimin me shoqatat që përfaqësojnë bashkitë apo përfaqësuesit e pushtetit vendor, nuk e kuptova qartë se cila mund të jetë analiza jonë paraprake për efikasitetin e këtyre strukturave, kur dihet që ka struktura për menaxhimin e procesit të integritetit europian në nivel vendor, ka struktura për barazinë gjinore pranë organeve të pushtetit vendor dhe besoj se këtu jemi në radhën e tretë, nëse nuk më ka shpëtuar gjë përtej dy çështjeve që rendita. Po në këtë pikë, besoj, mendoj ose

ngre pikëpyetjen pse zgjidhet nga pikëpamja e teknikës legislative me ligj. A ka ndonjë mundësi tjetër dhe për të mos shkuar me rregullim ligjor apo jo për këtë gjë? Them këtë se në rastin e strukturave në procesin e integritit europian ne kemi operuar ndryshe dhe më pas qoftë edhe me një akt të përbashkët të ministrit të Brendshëm dhe ministrit të Jashtëm, që mbulonte edhe çështjet europiane është bërë rregullimi i përshkrimit të punës së këtyre strukturave dhe çështjet administrative dhe financiare.

Nuk e di se cila mund të ketë qenë arsyeja pse kemi ardhur në ndryshim të ligjit, aq më shumë që është një ligj që kërkon një shumicë të cilësuar.

Pyetja e dytë që kam, që po të doni mund ta merrni si sugjerim, është se ndryshimi ka në fokus vetëm çështjet e migracionit, ndërkohë që nga eksperiencia ime problemi kryesor që ne kemi si shoqëri me shtetasit tanë që jetojnë jashtë atdheut, sidomos, ata që kthehen, sfidë kjo me të cilën ne u përballëm, sidomos gjatë krizës greke apo krizës në eurozonë, ishte riintegrimi i tyre. Pra, në rast se në pushtetin vendor këto zyra do të funksionojnë edhe si sportele për të marrë një informacion të unifikuar qoftë për mundësitë që ofrohen për biznes, për shkollimin e fëmijëve, për mësimin e gjuhës etj. Pra, e bëjmë që e bëjmë këtë ndryshim, pse nuk i japim edhe këtë lloj dimensionin në mënyrë që ta kemi më të plotë paketën për t'u shërbyer shtetasve shqiptarë me banim jashtë atdheut?

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Fjalën e ka kolegja Gjebrea për një koment dhe më pas, kolegu Fino! **Elona**

Hoxha – Unë po ndërhyj thjesht për të mos t'u ngatërruar, sepse strategjia e riintegritit të të kthyerve është nën juridiksionin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale. Ajo duhet të punojë, jo Ministria e Brendshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kuptova. Normalisht e kanë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, e kanë.

Mimi Kodheli – Zoti Ministër, a do të përgjigjeni ju pastaj do të flasë zoti Fino apo anasjelltas?

Pandeli Majko – Faleminderit!

Së bashku do të përgjigjemi.

Mimi Kodheli – Bashkë? Paralelisht, në kor, duo?

Pandeli Majko – Po, në kor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bëj shaka.

Po ta vini re, zyrat janë quajtur: struktura për diasporën dhe migracionin. Nëse do të ishte thjesht për fushën e interesit të shqiptarëve, të cilët kanë një status të qartë, do të ishte vetëm për diasporën.

Sipas shpjegimit që kemi bërë për legjislacionin edhe në komisionin e nderuar, është shtuar dhe migracioni në të cilën përfshihen edhe emigracioni, edhe imigracioni, që do të thotë se do të krijojmë zyra të specializuara, të përhershme. Këtë e kemi vënë te funksionet. Pastaj në lidhje me situatat që mund të krijohen, bashkitë mund të marrin masa të natyrave të ndryshme, por duhej në legjislacion, sepse po ndryshojmë funksionet e bashkisë. Është diçka parimore që normalisht do të ketë ndërhyrje domino në sistem, por ne nuk mund të ndërhyjmë më shumë sesa duhet dhe të jemi të sinqertë, që e menduam edhe këtë. U ulëm me përfaqësuesit e Ministrisë së Brendshme, nëse mund ta kalonim në mënyrë të njëanshme. Thjesht mund të kalohej si një urdhëresë apo si një marrëveshje e përbashkët, por duke qenë se kishte të bënte me funksionet e reja të bashkive dhe e dyta, meqë duhej diçka e standardizuar në marrëdhëniet me këtë shtresë, e cila nuk është vetëm sasi, por edhe cilësi në shoqërinë tonë, menduam se do të ishte gjëja më e mirë që të kalonte me ligjin që keni përpara.

Konsultimet me pushtetin lokal e bëmë pikërisht për këtë që sapo thashë sepse ishte shumë e rëndësishme që ata të kishin mirëkuptim. Ishte një ligj me 3/5 dhe nuk mund të vinim në parlament pa pasur jo vetëm thjesht nga pikëpamja e ligjit për konsultimin publik, por edhe për balancën midis ekzekutivit dhe pushtetit lokal, ishte e nevojshme kjo për situatën në vazhdim.

E përsëris me kënaqësi, që ne nuk kemi pasur asnjë zë kundër krijimit të kësaj strukture në pushtetin vendor.

Mimi Kodheli – Fjalën e ka kolegu Fino!

Bashkim Fino – Zoti Bushati, unë nuk merrem me sekretarët, por merrem me nivele të larta se edhe vetë jam nivel i lartë. Ju jeni sekretar grupi, se kaq ke arritur në këtë mandat.

Mundohu të kapësh ndonjë gjë tjetër!

Ka 2 pushtete: pushteti qendror dhe ai vendor. Më lejoni t'ju them, jo se ju nuk e dini, se ju për një kohë keni punuar me politikën e jashtme dhe mund ta keni harruar se këto 2 pushtete kanë qenë prej kohësh “antagoniste” me njëra-tjetrën për të rrëmbyer sa më shumë kompetenca. Është legjislativi, është Kuvendi mbi këto 2 pushtete që vendos ligjet se si të rregullohen marrëdhëniet mes tyre.

Nëse do të kishte ndonjë VKM apo ndonjë udhëzim ministri, siç pretenduat ju, të jeni të bindur që një kryetar bashkie që pavarësisht se është i pavarur dhe zgjidhet drejtpërdrejt nga populli, zgjedh edhe këshillin bashkiak përkatës edhe vepron, edhe nuk vepron, ndërsa një akt ligjor, një ligj, aq më shumë i cilësuar, siç është ligji për pushtetin vendor ta vendosësh dhe ta votosh dhe t'i thuash që ti në funksionet e tua përveç nenit 29 (ka 35 pika aty), do të kesh edhe këtë pikë për funksionimin e diasporës dhe emigracionit, ai është i detyrueshëm për t'u zbatuar dhe për të reaguar dhe i detyrueshëm për ministrat e linjës që t'i kthejnë përgjigje Kuvendit apo pushtetit qendror.

Një VKM apo një urdhër i brendshëm i ministrave do të ishte i nivelit shumë më të ulët. Nga kjo pikëpamje ne e kemi ngritur stekën, sepse mendojmë se është një funksion që bashkitë duhet ta bëjnë.

E kuptoj (mbase nën rreshta), shqetësimin tënd, që ky ligj do 84 vota, por unë mendoj se për funksionin në fjalë, siç e thashë edhe më përpara, qoftë edhe opozita e re që është aktualisht në parlament, qoftë opozita e vjetër (opozita e rrugës), që ka qenë në parlament, ka qenë gjithmonë e hapur dhe bashkëvepruese me ne kur ka qenë çështja për diskutimin e ligjit të pushtetit vendor.

Edhe deputetët e rinj të opozitës së re, që përfaqësojnë opozitën e vjetër të rrugës, janë absolutisht dakord me ne. Ata do të jenë dakord me projektligjin, sepse është një funksion, për të cilin ne u themi kryetarëve të bashkive se janë të detyruar të zbatojnë edhe këtë funksion të ri. Nuk ka asnjë gjë politike, apo me prapavijë politike, por ai është një detyrim ligjor, një funksion që ne ua japim kryetarëve të bashkive. Jemi të gjithë dakord dhe jam shumë i bindur që edhe në seancë plenare ky nen do të kalojë me sukses, se është thjesht shtim i një funksioni për kryetarët e bashkive dhe këshillave përkatëse të tyre, prandaj pyetjes së parë që bëtë ju, që pse vjen me ligj, u mundova t'i jap një përgjigje.

Për pyetjen e dytë, u përgjigj vetë ministri Majko.

Për pyetjen e parë desha të sqaroj se ligji është shumë më i rëndësishëm, se një VKM apo një udhëzim. Bëmë mirë që e bëmë me ligj.

A jemi të vonuar? Jemi.

Duhet ta kishim bërë dhe më parë? Mbase.

Në të ardhmen mund të ketë edhe funksione të tjera, që mund të lindin nga praktika që ne nuk i kemi planifikuar në këtë ligj dhe mund t'i bëjmë ndryshime të tjera më vonë. Mund t'i bëjmë, se nuk ka asnjë gjë të keqe. Në rastin konkret ministri Majko i ka sjellë këtu, i ka me pasion. Pse jo? Mund ta kalojmë me sukses, edhe me votën tuaj.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Fino për pozitivizmin dhe optimizmin e shfaqur si shoku im i vjetër i klasës!

Unë them ta kalojmë projektligjin në votim në parim, nen për nen dhe në tërësi, nëse nuk ka më pyetje dhe diskutime.

Hedhim në votim në parim projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore"".

Kush është dakord në parim me ndryshimet që sjell ministri i Shtetit për Diasporën? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Kalojmë te votimi i nenit 1, që thotë: "Pas nenit 29 shtohet neni 29/1, me këtë përmbajtje:..."

Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 1.

A jeni dakord me anulimin e nenit 2? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 3, që ndryshon nenin 44. "Në nenin 44, fjalët "... 31 mars ..." zëvendësohen me fjalët "... 31 maj ...".

Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

A jeni dakord që të ketë një nen të tretë për hyrjen në fuqi?

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është dakord në tërësi me projektligjin?

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe në tërësi ky projektligj.

Faleminderit, ish-ministri Bushati!

Falënderoj kolegët për seriozitetin dhe për mbështetjen!

Do të takohemi në mbledhjen e ardhshme!
Faleminderit dhe punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA